

**Për më shumë informata rreth Bashkimit Evropian në Kosovë**



**QENDRA INFORMATIVE DHE KULTURORE E BE-së**

Nëna Terezë nr.16, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0) 38 25 99 99, Fax:+381 (0) 38 25 99 25  
E-mail: [info@euicc-ks.com](mailto:info@euicc-ks.com) dhe [helpdesk@euicc-ks.com](mailto:helpdesk@euicc-ks.com)  
Web: [www.euicc-ks.com](http://www.euicc-ks.com)  
Orari i punës: E hënë – E premte: 9:00 deri 18:00

**QENDRA INFORMATIVE DHE KULTURORE E BE-së**

Cika Jovina p.n , veriu i Mitrovicës, Kosovë  
Tel:+381 (0) 64 44 04 662  
E-mail: [euip@euicc-ks.com](mailto:euip@euicc-ks.com)  
Orari i punës: E hënë – E premte: 9:00 deri 18:00



**ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË**

Rruga e Kosovës 1, kutia postare 331, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 51 31 200; Fax: +381 (0)38 51 31 305  
E-mail: [delegation-kosovo@eeas.europa.eu](mailto:delegation-kosovo@eeas.europa.eu)  
Web: <http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo>

ISBN 978-92-9238-101-1







Dhjetë shanset  
më të mira evropiane  
të Kosovës



Bashkimi Evropian





Dhjetë shanset më të mira evropiane  
të Kosovës



Bashkimi Evropian





# Hyrje



Samuel Žbogar,  
Shef i Zyrës së BE-së dhe  
Përfaqësues Special i BE-së  
në Kosovë

Po, ne mund të bëjmë mrekulli – së bashku!

Kur ndokush ka përballë një përmbledhjeje të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian në Kosovë, siç është rasti me këtë broshurë, së paku dy mendime përshkojnë mendjet tona. Së pari, sa të holla janë investuar në të vërtetë deri tani në këtë anëtar të ardhshëm të familjes evropiane. Dhe së dyti, kur përvojat dhe ekspertiza evropiane bashkohet me popullin dinamik dhe ambicioz të Kosovës, mrekullitë janë të mundshme!

Realizimi i tri korrjeve; lëvizja nga kampi i kontaminuar me plumb në një shtëpi të mirëfilltë; hapja e një miniere thëngjilli me kapacitet eksploatimi prej 124 milionë tonë thëngjilli; restaurimi i një kulle 200 vjeçare dhe kthimi i saj në bibliotekë me tre-kate; të fituarit e një kuizi kombëtar për shkolla që do të dërgojë fëmijë në një udhëtim aventure përgjatë tërë Evropës; shkrimi i një “letre për vetën time në të ardhmen” – a nuk janë të gjitha këto të arritura, një lloj e mrekullisë moderne?

Këto janë bërë të mundura për shkak të përpjekjeve të përbashkëta të vendim-marrësve, fondeve të para-anëtarësimit, ekspertëve me përvojë dhe njerëzve të vullnetit të mirë për ta ndryshuar Kosovën në një vend më të mirë për të jetuar, studiuar, punuar, për të rritur fëmijët dhe thjeshtë për ta gëzuar. Kjo broshurë është përplot kësi tregimesh. Por ajo që i bënë ato të vërteta, janë njerëzit. Një nxënëse e klasës së 9-të, Diellza Kastrati, fituesja e kuizit; zdrukthëtari 58 vjeçar Ahmet Topaj; banori i ri i Mëhallës Rome Sedat Bahtiu, dhe shumë e shumë individë të tjerë janë heronjtë e vërtetë të këtyre tregimeve. Për shkak se investimet e BE-së në fusha të ndryshme thjeshtë kanë ndryshuar jetën e tyre – dhe kanë ndryshuar historikun e tyre për ta kthyer atë në një tregim suksesi.

Dhe pikërisht kjo është arsyeja pse ne, Bashkimi Evropian, jemi këtu: për të ndihmuar në ndryshimin e jetëve të njerëzve për të mirën. Gjatë një viti të qëndrimit tim në Kosovë si Shef i Zyrës së BE-së dhe si Përfaqësues Special i BE-së, unë kam pas rastin të vizitojë shumë komuna të Kosovës. Kudo që kam vërejtur projekte të financuara nga BE-ja, apo jam takuar me njerëz që kanë qenë të përfshirë në ndonjë aktivitet të financuar nga BE-ja, ndjenjat tona të ndërsjella ishin ato të krenarisë. Ata ishin krenarë për rezultatin që do të ndihmojë në përmirësimin e jetës së tyre – dhe mburrëshin për shkak se ishin pjesë e atij procesi. Është shumë gjë e mirë kur besimi i ndërsjellë lind nga krenaria. Kjo është mënyra se si lindin miqësitë afatgjate dhe si krijohet e ardhmja. Sepse e ardhmja e Kosovës është e ardhme evropiane – dhe Kosova, është e ardhmja jonë evropiane.



# Përmbajtja



ARSHIMI PËR NJË TË ARDHME MË TË NDRITUR

faqe 8



MË SHUMË LOJËRA DHE MUNDËSI PËR TË MËSUAR PËR FËMIJËT

faqe 10




PËRKRAHJA E TRASHËGIMISË KULTURORE TË PASUR DHE INICIATIVAVE KULTURORE

faqe 12



ARRITJA E STANDARDEVE EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

faqe 16



INICIATIVAT PËR KOSOVËN E GJELBËR

faqe 18



## MBJELLJA E FARËS PËR ZHVILLIM RURAL

faqe 20

---



## PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NË KOSOVË

faqe 22


---



## SHFRYTËZIMI I NDËRGJEGJSHËM I ENERGJISË

faqe 24

---



## KRIJIMI I MIRËBESIMIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

faqe 26

---



## RIKTHIMI I BESIMIT NË SUNDIMIN E LIGJIT

faqe 28

---





ARSIMIMI PËR NJË TË ARDHME MË TË NDRITUR





E ardhmja e begatë e çdo vendi sa i përket rritjes ekonomike dhe stabilitetit shoqëror e politik qëndron në duart e rinisë së vet. Kjo është veçanërisht e vërtetë për Kosovën. Në aspektin demografik popullsia e Kosovës është më e reja në Evropë, ku gjysma e popullsisë është nën moshën 25 vjeçare. Prandaj, investimi tek të rinjtë e Kosovës është tejet me rëndësi për zhvillimin e një shteti që mëton integrimin evropian.

### E ardhmja digjitale

Për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve dhe të të rinjve në Kosovë, Bashkimi Evropian (BE) ka ofruar financim për trajnim profesional, për nxënës me aftësi të kufizuara, si dhe për përmirësimin e infrastrukturës edukativo-arsimore për të krijuar një mjedis më të mirë mësimor.

Së voni, arsimimi në teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (TIK) është vënë në fokusin e investimit të BE-së. Vendet anë e mbanë Evropës e kanë pranuar rëndësinë e përgatitjes së fëmijëve të tyre për të ardhmen digjitale, dhe si rrjedhojë edhe Kosova është duke e ndjekur të njëjtin drejtim. Përmes Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT) të Kosovës, BE-ja është duke e promovuar mësimin elektronik dhe mësimin e teknologjisë informative dhe të komunikimit me anën e një projekti 3 milionë eurosh.

Kjo nismë filloi duke i pajisur 40 shkolla dhe institucione arsimore me pajisje të teknologjisë informative. Në ndërkohë, 2,000 mësimdhënës janë aftësuar në protokollin e TIK-ut dhe të mësimin elektronik. Trajnimi u është ofruar edhe hartuesve të përmbajtjeve elektronike me qëllim që të sigurohet harmonia e materialeve mësimore dhe të teksteve mësimore. Mësimdhënësit dhe nxënësit që i kanë përdorur pajisjet e reja të teknologjisë dhe të mësimin elektronik në klasë thonë se fotografitë dhe videot ndërvepruese u ndihmojnë që t'i gjallërojnë më shumë temat të cilat i zhvillojnë. "Tani e kemi më të lehtë ta kuptojmë mësimin sepse ato janë më interesante dhe më tërheqëse, dhe se temat të cilat i mësojmë ilustrohen më mirë", shprehet nxënësi Engjëll Hamiti.

### Një kornizë moderne e kurrikulimit

Përveç nismave për digjitalizim, BE-ja është duke e ndihmuar Kosovën në modernizimin e sistemit të saj arsimor në shkallë më të gjerë. Falë një projekti prej 3 milionë eurosh është krijuar korniza e kurrikulimit të Kosovës, ndërsa sillabuset e kurrikulimit bërthamë janë duke u hartuar nga MASHT-i me ndihmën e ekspertëve nga projekti i BE-së për Qasje Tërësektoriale të Arsimit (SWAp).

Sipas Ramush Lekajt, udhëheqës i Departamentit për planprograme në MASHT, përkrahja e BE-së ka ndihmuar në zbatimin e metodave moderne të mësimdhënies në Kosovës, në veçanti të qasjeve të bazuara në kompetenca dhe të metodave me nxënësin në qendër.

### Një aventurë evropiane

Për Diellza Kastratin, një nxënëse e klasës së 9-të nga fshati Karaqevë e Kamenicës, vizita turistike 11 ditore nëpër Evropë ishte një përvojë e jashtëzakonshme që e ka ndryshuar jetën e saj. Së bashku me katër nxënës të tjerë të shkollës së saj, ajo i vizitoi qytetet më të famshme të Evropës, si Parisin dhe Mynihun, pastaj institucionet e BE-së në Bruksel dhe Luksemburg. Kjo përvojë bëri që Diellza t'i avancojë edhe më tej njohuritë e saj teorike për Evropën dhe historinë e saj.

Vizita ishte një shpërblim për Diellzën dhe shokët e shoqet e klasës së saj me rastin e fitimit të "Kuizit Evropa", i cili u mbajt në shkallë vendi. Kuizi erdhi si rezultat i rritjes së interesit të të rinjve për Bashkimin Evropian. Njëzetë e katër shkolla kanë konkurruar mes veti në fazën e parë të "Kuizit Evropa", i cili u mbajt në vitin 2011. Diellza dhe ekipi i saj nga shkolla "Avni Kastrati" e fituan trofeun, dhe iu dha mundësia që ta bëjnë një aventurë nëpër Evropë.

Pyetjet dhe përgjigjet në kuiz ishin nxjerrë prej një teksti shkollor të titulluar "Le të nisemi për në Evropë", i cili është shtypur dhe u është shpërndarë shkollave konkurrencte nga projekti Perspektiva e Bashkimit Evropian në Kosovë (EUPK). "Ky libër e ka provokuar kërkimin e nxënësve për të mësuar më shumë për Evropën", thotë Ramush Lekaj, i cili e udhëheq departamentin e Planprogrameve në MASHT.

Ministria është duke planifikuar që ta shpërndajë këtë libër tek të gjitha shkollat fillore në Kosovë para fillimit të vitit shkollor 2012/13. Po ashtu, është duke e shqyrtuar mundësinë e përdorimit të librit si pjesë zgjedhore për planprogramin e klasës së 9-të.

### Ta njohësh Evropën përmes mundësive të studimit

Falë një programi postdiplomik të financuar nga BE-ja, një grupi prej 222 studentëve nga Kosova u është dhënë mundësia që t'i provojnë praktikën më të mira arsimore të vendeve të BE-s. Përmes skemës së Celulës së të Rinjve organizohen studime praktike postdiplomike në universitete të përzgjedhura në Evropë. Me rastin e kthimit në Kosovë, studentët duhet të punojnë për administratën publike.

Qëllimi i skemës së Celulës së të Rinjve është që të ketë sa më shumë ekspertizë tek shërbyesit civil në sektorët kryesorë të administratës publike të Kosovës. Të diplomuarit do ta shfrytëzojnë njohurinë e tyre të fituar nga vendet dhe politikën e BE-s për ta ndihmuar qeverinë e Kosovës që t'i përmbush obligimet e saj gjatë procesit të integritetit në BE.

Disa citate nga fituesit e "Kuizit Evropa":

- "E kam ëndërr ta studiojë arkitekturën evropiane".
- "Mendimi im për Evropën ka ndryshuar për të mirë, duke parë dhe duke mësuar për kulturat në Evropë".
- "U impresionova nga Parlamenti Evropian".
- "Kemi mësuar për mundësitë e studimit në Evropë".
- "Jam impresionuar me qytetet evropiane të cilat i kam vizituar".

### PËRFITUESE E SKEMËS SË CELULËS SË TË RINJVE Valëza Ukaj

- Ka studiuar ekonominë e BE-së dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të BE-së në Leuven, Belgjikë
- Punon në Departamentin për Integrim Evropian dhe Bashkërendim të Politikave në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

"Përveç ligjëratave nga profesorët më të mirënjohur botëror në fushën e çështjeve të BE-së, kemi zhvilluar praktika të veçanta në fushën juridike të cilat ishin tejet të dobishme".

### PËRFITUESE E SKEMËS SË CELULËS SË TË RINJVE Vjosa Beqaj

- Ka studiuar menaxhment dhe mjedis në Universitetin e Lankasterit, Mbretëri të Bashkuar
- Punon si ushtruese detyre e drejtorit për Departamentin e Infrastrukturës dhe Burimeve Natyrore në Ministrinë e Integritetit Evropian.

"Përveç kënaqësisë gjatë ligjëratave të shkëlqyera, ballafaqimit me një sistem tjetër arsimor si dhe të eksplorimit të kulturës lokale, po ashtu fitova njohuri se si aspektet mjedisore mund të zbatohen me sukses në vendet e zhvilluara. Si politik-bërës, ne përpiqemi që ta përmirësojmë qasjen e shoqërisë në çështjet mjedisore".

### PËRFITUES I SKEMËS SË CELULËS SË TË RINJVE Florim Canolli

- Kastudiuar për studimet evropiane në Universitetin Westminster në Londër, Mbretëri të Bashkuar.
- Punon në Ministrinë e Integritetit Evropian

"Përvoja ime me skemën e Celulës së të Rinjve ma kujton thënien e famshme të Jul Çezarit "Veni, vidi, vici" ("Erdha, e pashë, e pushtova"). Përvoja dhe kualifikimi akademik më kanë ndihmuar që ta krijojë një karrierë të qëndrueshme në kuadër të administratës publike në Kosovë. Tani po i promovojë në mënyrë aktive dhe me sukses vlerat dhe praktikën më të mira evropiane në Kosovë".





MË SHUMË LOJËRA DHE MUNDËSI PËR TË MËSUAR PËR FËMIJËT





Pjesëmarrja e rregullt në aktivitete sportive dhe rekreative u mundëson fëmijëve të jenë së bashku si dhe të jenë të shëndetshëm e aktiv. Po ashtu, mund të ndihmojë në krijimin e bashkësive gjithëpërfshirëse dhe të shëndetshme. Duke e ditur se ka mungesë të objekteve të përshtatshme sportive dhe rekreative për të rinj në Kosovë, Bashkimi Evropian ka dhënë fonde për ndërtimin e fushave të reja sportive, lojërave për fëmijë, si dhe qendrave rekreative në mbarë vendin.

Iniciativa e “Të rinjve në Mitrovicë” është shembulli i shkëlqyeshëm i përfitimit të investimit të BE-së. Njëra prej lagjeve të qytetit është pajisur tanimë me njërën prej objekteve më të reja sportive. Në të tani zhvillohen ndeshje të rregullta në futboll e basketboll, si dhe ofrohen mësim të tenisit për fëmijët e lagjes për të gjitha moshat. Kjo hapësirë përfshinë edhe një fushë të lojërave për fëmijët. Në shenjë falënderimi për këtë investim të BE-së, autoritetet komunale janë të përkushtuar që ta mirëmbajnë këtë hapësirë sipas standardeve më të larta.

Qendra e re sportive dhe kulturore në fshatin Llabjan në komunën e Novobërdës u mundësua po ashtu përmes financimit të BE-së. Kjo hapësirë ultra moderne përfshinë një fushë shumë-dimensionale për basketboll, hendboll, volejball dhe futboll, si dhe mund t’i mbajë deri në 320 spektatorë. Qendra gjithashtu përbëhet prej një studio baleti dhe vallëzimi, si dhe një biblioteke.

Fusha të reja sportive dhe të lojërave janë ndërtuar edhe në Prishtinë, Pejë dhe Prizren. Të gjitha këto hapësira e objekte të reja janë ndërtuar sipas standardeve dhe udhëzimeve të BE-së për siguri dhe qëndrueshmëri.

### “Lojë për të gjithë”

Qershori është një muaj i veçantë për fëmijët e Kosovës. Festivali për fëmijë “Lojë për të gjithë” i inkurajon fëmijët e të gjitha moshave që të dalin në rrugët e Prishtinës për një javë rresht me aktivitete, parada dhe festime të ndryshme.

Festivali është një projekt që financohet nga BE-ja dhe realizohet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës, si dhe nga Qendra për Arte Pamore Multimediale. Ky festival tani ka hyrë në vitin e tretë. Festivali “Lojë për të gjithë” u mundëson fëmijëve anëmbanë Kosovës që të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme krijuese, të shohin filma, si dhe të shkojnë në interpretime teatrale si dhe ato nëpër rrugë të hapura. Qëllimi është që t’u ofrohet të rinjve mundësia që të mësojnë përmes aktiviteteve arsimore dhe rekreative, si dhe të kenë mundësi ta shprehin talentet dhe krijimtarinë e vet.

Projekti është unik në Kosovë sepse ofron një numër të madh aktivitete në të cilat përfshihen dhe punojnë bashkërisht fëmijët e të gjitha grupeve shoqërore. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara ose të komuniteteve të pakicave ndihmon në kultivimin e mirëbesimit mes gjeneratave të ardhshme.

Festivali i fëmijëve “Lojë për të gjithë” është shndërruar në një festival tradicional, dhe i ka vendosur fëmijët kosovarë në hartën e Evropës me ngjarje të veçanta dhe unike kombëtare. Me përfundimin e javës së festivalit fëmijët mund të vazhdojnë të marrin pjesë në gara të ndryshme gjatë tërë vitit ku ofrohen çmime për fituesit. Për shembull, në vitin 2011 pesë shkolla kanë përfituar grante investuese nga BE-ja pasi kanë fituar në konkurrencën e hapur të ideve për përmirësimin e mjediseve në vendet publike. Janë dhënë shpërblime edhe për tri esetë më të mira në temën “Letër vetës sime në të ardhmen”.







PËRKRAHJA E TRASHËGIMISË KULTURORE TË PASUR  
DHE INICIATIVAVE KULTURORE





Jeta kulturore dhe trashëgimia e një vendi janë pjesë të rëndësishme të identitetit kombëtar. Gjithashtu, ato ofrojnë një mundësi për zhvillimin e turizmit, si dhe të përfshirjes së bashkësive lokale si në aspektin social ashtu edhe atë ekonomik.

Me përkrahjen dhe inkurajimin e Bashkimit Evropian, profili kulturor i Kosovës tani po zhvillohet në mënyrë aktive, si në nivel regional ashtu edhe në atë evropian. Përveç financimit të aktiviteteve të ndryshme kulturore, BE-ja është duke ndihmuar në restaurimin e kështjellave, monumenteve dhe lokacioneve të ndryshme me rëndësi për trashëgiminë kulturore. Kosova po e risjellë krenarinë e saj të pasur të trashëgimisë kulturore.

## Beledije

Qyteti i Prizrenit në brigjet e lumit Lumbardh është njëri prej qendrave të kahershme me rëndësi ekonomike dhe kulturore në Kosovë. Beledije, një shtëpi e shekullit të XVIII-të përbën një prej objekteve të vjetra historike dhe kulturore të qytetit, dhe shembull të trashëgimisë arkitektonike të Kosovës. Gjatë periudhës së perandorisë osmane, Beledije shërbente si zyrë komunale. Megjithatë, pas restaurimit në vitin 2011 përmes fondeve të BE-së, ajo është bërë qendra e parë trajnuese për trashëgimi kulturore në rajonin e Ballkanit.

Qendra ofron trajnime të specializuara për ndërtimtarë dhe arkitektë të lidhur me teknikat delikate që përdoren në restaurimin e ndërtesave dhe monumenteve të vjetra e të lashta. Po ashtu ofrohen kurse trajnimi në fushat e tjera të aktiviteteve kulturore, për shembull, menaxhimi i muzeve dhe konservimi i artefakteve të vjetra. Për të gjeneruar të ardhura shtesë, Beledije do të mundësojë edhe mbajtjen e ngjarjeve kulturore për vendet e tjera jashtë Kosovës.

Gjersa Kosova ka aktualisht një numër të kufizuar të ekspertëve të fushës së trashëgimisë, Vjollca Aliu, shefe e Divizionit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës, shpreson që qendra e Beledijes të luaj një rol vital në zhvillimin e aftësive në këtë sektor. Kujtim Gashi prej sektorit të kulturës së komunës së Prizrenit është gjithashtu optimist për të ardhmen: “Si qendër rajonale, Beledije ofron mundësi reale për zhvillimin dhe konservimin e trashëgimisë tonë kulturore”, shprehet ai.

## Restaurimi i kullave tradicionale në Junik

Me qindra vjet shqiptarët e Kosovës perëndimore kanë përdorur metoda tradicionale të ndërtimit të shtëpive prej gurit dhe drurit. Kjo zeje e lashtë nuk praktikohet më në Kosovë, dhe shumica e shtëpive të vjetra shqiptare prej guri (kullat) ose janë shkatërruar ose janë në gjendje të mjerueshme.

Komuna e Junikut kishte mbi 200 kulla dhe me dhjetëra mullinj prej guri. Për fat të keq, shumica e tyre janë shembur me kalimin e kohës, dhe së bashku me to është zhdukur edhe një pjesë e trashëgimisë arkitektonike e Junikut. Sot kanë mbetur vetëm rreth 20 kulla të cilat qëndrojnë në këmbë në Junik.

Falë fondeve të BE-së, këtyre pak kullave që kanë mbetur po ju kthehet një jetë e re. Është duke u realizuar një program i restaurimit të këtyre kullave të dëmtuara që të shndërrohen në objekte moderne funksionale. Kryetari i komunës së Junikut, Agron Kuçi u shpreh: “Gjersa përdoren metoda moderne të ndërtimit për t’i restauruar këto objekte, po i kushtohet kujdes i madh ruajtjes së pamjes së tyre tradicionale”.

## Kulla e Hoxhajve

Njëra prej shtëpive të vjetra shqiptare prej guri në Junik, Kulla e Hoxhajve, është restauruar me ndihmën financiare përmes programit “Kosova e Bukur”, një iniciative e financuar nga BE-ja për ta përmirësuar infrastrukturën urbane dhe në të njëjtën kohë të ofrojë punësim për vendasit.

Banorët e Junikut tani kanë një bibliotekë krejtësisht të re trekatëshe, e cila zë mijëra libra dhe një personel prej tre bibliotekarëve me orar të plotë. Kulla mund të përdoret edhe si galeri dhe për ngjarje të tjera kulturore.

Zdrukhëtari Ahmet Topaj, 58 vjeçar, e ka realizuar inspektimin përfundimtar sa i përket cilësisë së punimeve prej druri në kullën e sapo rinovuar. Ahmeti ka jetuar në një objekt të tillë për shumë vite, dhe u kënaq me idenë se ka arritur të jap ndihmën e vet në restaurimin e kësaj shtëpie 200 vjeçare prej guri. “Ishte në kushte mjaft të këqija. Kurrë s’ma kishte marrë mendja se do të kthehej në një vend kaq të dashur”, shprehet ai.

Ky projekt afatshkurtër ishte i mirëseardhur për Ahmetin dhe 33 punëtorët e tjerë të kësaj zone, të cilët punuan në restaurimin e kullës, dhe të cilët ishin përzgjedhur përmes qendrës lokale për punësim.









## Dokufest

Festivali ndërkombëtar i filmit dokumentar dhe të shkurtër – Dokufest, është njëri prej festivaleve më të njohura dhe më të konsoliduara në Kosovë. Më shumë se gati një dekadë vizitorët ia kanë mësyer qytetit të Prizrenit për të shikuar filma të rinj dhe dokumentarë në hapësira të ndryshme të mbyllura si dhe të hapura në qytet.

Zyra e BE-së në Kosovë dhe organizatorët e Dokufestit kanë krijuar një bashkëpunim të fuqishëm për t'i promovuar të drejtat e njeriut përmes artit. Gjatë Dokufestit 2012 u prodhuan gjashtë dokumentare për të drejtat e njeriut të financuara përmes fondeve të BE-së.

Me kalimin e viteve, BE-ja është përqendruar po ashtu në mbështetjen e shkëmbimit kulturor rajonal. “Bashkimi Evropian ka kontribuar në zhvillimin e festivalit, posaçërisht duke na ndihmuar që të forcohem në konkurrencën rajonale”, shprehet Aliriza Arënlju, drejtor ekzekutiv i Dokufestit.

## Kulturë për të gjithë

Identiteti kulturor i Kosovës po e merr formën e duhur. Iniciativa “Kulturë për të gjithë”, që financohet prej BE-së, dhe realizohet prej disa OJQ-ve, i ka promovuar deri më tani 30 projekte të vogla në shkallë vendi. Në ndërkohë, qeveria e Kosovës është zotuar se do t'i mbështet aktivitetet kulturore.

Idetë për aktivitete të reja kulturore e inkurajojnë dimensionin evropian. Valëza Ukaj, ushtruese detyre e drejtoreshës për Integrim Evropian dhe Bashkërendim të Politikave në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shprehet kështu: “Iniciativa ‘Kultura për të gjithë’ jo vetëm që e ngrit vetëdijen e llojlojshmërisë së brendshme kulturore të Kosovës, por edhe të llojshmërisë kulturore të BE-së”.

Informatat për organizimet dhe aktivitetet kulturore në shkallë vendi do të përmbledhen në “hartën kulturore” në mënyrë që njerëzit ta kenë më të lehtë t'i gjejnë aktivitetet që organizohen në shkallë lokale apo të vendit dhe që paraqesin interes për ta.

## Promovimi i turizmit në Dukagjin

Në rrafshin e Dukagjinit të Kosovës perëndimore, edhe një kullë tjetër ishte përcaktuar që të bëhej zyrë koordinuese për turizëm. Lokacioni i shkëlqyer në të cilën ndodhet objekti, në rrëzë të majës së Gjeravicës (bjeshka më e lartë në Kosovë prej 2,656 metrave), e bën atë një vend ideal për përmbushjen e këtij qëllimi.

Iniciativa “Shihemi në Dukagjin” ka për qëllim që ta ringjallë traditën e kahershme të turizmit në këtë rajon. Partneri realizues, Trashëgimia kulturore pa kufinj, e sheh turizmin si në mjet të rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe të ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë. Zyra e re turistike do të udhëhiqet nga një personel profesional i trajnuar dhe do të ofrojë shërbime të klasës së parë për vizitorët në këtë rajon. Kjo zonë ka vende të ndryshme turistike, duke përfshirë lokacione të trashëgimisë botërore, shtëpi tradicionale, hamame, liqene glaciale, si dhe hapësira të tjera të bukurive të papara natyrore.

## Festivali i Xhazit në Prishtinë

Ndryshe prej pjesës tjetër të Evropës, ngjarjet e xhazit vijnë më rrallë në Kosovë. Megjithatë, gjatë një jave për çdo vit Prishtina bëhet qendër tërheqëse për dashamirët kosovarë të xhazit.

Festivali i xhazit në Prishtinë është zhvilluar në njërin prej ngjarjeve më të rëndësishme kulturore në Kosovë. Që prej vitit 2005, dashamirët e xhazit ia kanë mësyer qytetit për shtatë ditë rresht për të ndjekur koncerte të xhazit, sesione përgatitore, si dhe seminare të ndryshme. Java e festivalit për disa është një mundësi për të dëgjuar interpretime të drejtpërdrejta të muzikës xhaz.

Qëllimi kryesor i organizatorëve të festivalit është promovimi i artistëve të rinj. Taulant Mehmeti, kitarist 20 vjeçar i xhazit, i interpretoi kompozimet e tij për herë të parë në festivalin e vitit 2011. “Ishte një ndjenjë e pa përshkruar që të luaja përpara një audience që e vlerëson muzikën xhaz, dhe u kënaqëm me të”, shprehet ai. “Koncertet gjatë festivalit janë mundësia e jonë e vetme që të kënaqemi me muzikën e drejtpërdrejtë xhaz në Kosovë”, shton ai.

Veçoritë e tjera që e bëjnë këtë ngjarje kaq të veçantë për muziktarët e rinj të xhazit janë mundësitë për të luajtur në sesionet përgatitore me artistët ndërkombëtarë, si dhe diskutimet që bëhen lidhur me aspekte të ndryshme të xhazit gjatë seminareve. Drejtori i festivalit Ilir Bajri thotë se festivali e thekson rëndësinë e simulimit të bashkëpunimit artistik si dhe të shkëmbimit me vendeve dhe kulturave.

## Krijuesit e rinj

Në harmoni me trendet e BE-së për shfrytëzimin e qasjeve krijuese për mendim dhe shkrim kritik, OJQ-ja Integra e ka sajuar një ide të re interesante për trajtimin e çështjeve sociale në Kosovë. Të rinjve u kërkohet që të krijojnë në shpejtësi një numër të sloganeve lidhur me temat që kanë të bëjnë, mes tjerash, me arsimin, korrupsionin, integrimin evropian, etj. Grupet e të rinjve mblidhen së bashku për të diskutuar dhe për të krijuar slogane përmes një varg takimesh. Posa ta kenë shteruar një temë dhe përcaktohen për një slogan, ata vazhdojnë me temën tjetër.

Në këtë mënyrë, janë krijuar, shtypur dhe shpërndarë me mijëra slogane nëpër qytetet e Kosovës, dhe të cilat janë mbuluar dukshëm nga valët e radios. Sloganet përpilohen në atë mënyrë që ta rrisin vetëdijen e publikut sa i përket problemeve të ndryshme shoqërore. Njëri prej sloganeve shkruan kështu “Ëndrra evropiane po më mbyt”, e cila i referohet çështjeve komplekse sa i përket marrëdhënieve Kosovë – BE; siç janë për shembull kufizimet për qytetarët e Kosovës që dëshirojnë të udhëtojnë në vendet e BE-s.

Nëse ndalemi pak dhe mendojmë për këtë slogan dhe për problematikën që e trajton, atëherë ai e ka arritur qëllimin. “Stili i sloganeve janë plot domethënie, të kombinuara me një dizajn të thjeshtë, por artistik”, thotë Kushtrim Koliqi, drejtor i Integres. Ai shton: “Ky është një format inovativ dhe unik për trajtimin e çështjeve shoqërore. I bën njerëzit të mendojnë, por ne nuk jemi pjesë të zgjidhjes”.





ARRITJA E STANDARDEVE EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT





Në Kosovë sot jetojnë afro 40,000 romë, ashkali dhe egjiptas (RAE). Këto pakica janë më të varftrat dhe më të rrezikuarat e shoqërisë, të rrethuara me një varg problemesh sociale si papunësia, strehimi i papërshtatshëm, si dhe qasja e kufizuar në arsim dhe kujdes shëndetësor. Përmirësimi i mirëqenies socio-ekonomike dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut për këto pakica të marginalizuara është synimi i disa iniciativave të financuara nga Bashkimi Evropian.

### Mëhalla e Romëve

Një prej shembujve është Mëhalla e Romëve në lagjet e Mitrovicës, një zhvillim i ri, i cili ka për synim ri-strehimin e romëve, ashkalive dhe egjiptasve të zhvendosur nga kampi i afërm i refugjatëve. Autoritetet lokale e kanë caktuar një hapësirë për këtë zhvillim, dhe se BE-ja i ka investuar 5 milionë euro në këtë projekt.

Lagja e re e ka të kompletuar tërë infrastrukturën urbane si dhe ka qasje të lehtë në qendrën e qytetit. “Ne kemi ofruar një lokacion të klasit të parë për këtë nismë humane. Komunitetet rome, ashkali dhe egjiptase pa dyshim se i gëzojnë kushtet më të mira të jetesës në krahasim me pjesën tjetër të rajonit, ose edhe me vendet e Bashkimit Evropian”, shprehet Avni Kastrati, kryetar i komunës së Mitrovicës.

Shtatëdhjetë e një familje të këtyre komuniteteve janë vendosur tashmë në mëhallën e romëve. Njëri prej banorëve të ri, Sedat Bahtiu, është falënderues që familja e tij tani mund ta jetojë një jetë normale, dhe se katër fëmijët e tij kanë qasje në shkollim të plotë. “Gjithçka ka ndryshuar për të mirë”, shprehet ai. “Nuk mund të krahasohet jeta në kamp me shtëpinë në të cilën tash po jetojmë”.

### Një e ardhme më e ndritur për Avdylin

Avdyli pesëvjeçar i ka kaluar vjetët e para të jetës së tij në një kamp refugjatësh në veri të Mitrovicës. Edhe pse duket si një djalosh normal dhe i shëndetshëm, testet klinike kanë gjetur nivel të lartë të plumbit në gjakun e tij si rezultat i kontaminimit me plumb të kampit.

Por jeta është duke u përmirësuar për Avdylin. Ai dhe familja e tij janë vendosur së voni në mëhallën e romëve, dhe se po trajtohet si duhet në aspektin mjekësor. Kujdesi mjekësor për Avdylin është pjesë e një projekti më të zgjeruar të financuar nga BE-ja për ta mbështetur rivendosjen e bashkësive rome, ashkali dhe egjiptase nga kampet e kontaminuar me plumb të Osterodes dhe Cesmin Lugut. Përveç kësaj, Organizata Botërore e Shëndetësisë, në partneritet me autoritetet e Kosovës, e ka miratuar një program të analizës dhe trajtimit për fëmijët që vuajnë nga helmimi me plumb.

### Gjetja e një profesioni

Pjesë e procesit të ri-integrimit të bashkësive rome, ashkali dhe egjiptase është edhe programi për arsimin dhe aftësimin profesional. Për shembull, një floktare profesioniste në Mitrovicë ofron praktikë për nënat e reja nga këto bashkësi. Ajo sheh potencial të vërtetë në karrierë për disa prej të trajnuarve.

Fatime Jahirovici është njëra prej 30 grave të cilat janë përfshirë në këtë kurs trajnimi. Ajo ka pasur sukses të mirë, dhe tani është në kërkim të karrierës së saj në floktari, dhe një ditë të ketë sallonin e saj të bukurisë. Fatimja është në mesin e disa njerëzve e cila ka marrë grant nga BE-ja për trajnim profesional, si dhe që kualifikohet për grante të vogla financiare për nisje të bizneseve.

### Arsimi

BE-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT) ka dhënë 220 bursa universitare dhe për shkollim të mesëm për nxënësit dhe studentët e bashkësive rome, ashkali dhe egjiptase. Iniciativa është pjesë e një plani të veprimit të krijuar nga Ministria e Integrimit Evropian dhe Komisioni Evropian për promovimin e integrimit të bashkësive rome, ashkali dhe egjiptase. Synimi përfundimtar është rekrutimi i pjesëtarëve të këtyre bashkësive në sektorin publik, dhe rritja e përfaqësimit të tyre në proceset shoqërore dhe në vendimmarrjen lokale. Përmirësimi i qasjes në arsim është thelbësore për t’ju ndihmuar këtyre bashkësive që të jenë tërësisht të barabarta me shoqërinë kosovare.

### Ruajtja e trashëgimisë kulturore

Rritja e vetëdijes së kulturës dhe traditave rome, ashkali dhe egjiptase mund ta përmirësojë statusin e këtyre pakicave në Kosovë. Festivali i kulturës rome, ashkali dhe egjiptase tashmë ka hyrë në vitin e dytë, dhe është një festë e rëndësishme e trashëgimisë së këtyre bashkësive. Gjatë festivaleve të vitit 2011 dhe 2012 janë mbajtur një varg ngjarjesh kulturore, duke përfshirë lojëra, filma, koncerte, lexim poezish, ekspozita fotografish, të cilat janë shfaqur në Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë.

Progresi i suksesshëm drejt anëtarësimit në BE do të varet prej zotësisë së Kosovës për të siguruar të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e saj. Në veçanti, sigurimi i të drejtave të njeriut të pakicave është një sfidë e rëndësishme për shoqërinë kosovare në tërësi.





# INICIATIVAT PËR KOSOVËN E GJELBËR





Investimet kapitale në një varg projektsh të infrastrukturës në Kosovë ka ndikuar pozitivisht në cilësinë e mjedisit të vendit. Ajri, dheu dhe uji janë më të pastër dhe bëjnë që qytetarët të kenë një jetë më të mirë.

### Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave

Gjatë shtatë vitesh mes vitit 2001 dhe 2008 janë mbyllur dhe rehabilituar 21 lokacione të pakontrolluara dhe të rrezikshme të deponive, ndërsa në anën tjetër janë ndërtuar gjashtë deponi të reja për menaxhimin e mbeturinave në qytetet kryesore të Kosovës. Investimi është bërë nga Bashkimi Evropian në mënyrë që sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë të përmirësohet dhe të jetë në harmoni me politikën e BE-së sa i përket mbrojtjes së mjedisit, ndotjes, dhe përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave.

Ky përmirësim mjedisor mori mbështetje edhe më të madhe kur BE-ja e financoi projektin për mbylljen dhe rehabilitimin e tetë lokacioneve të tjera të pakontrolluara të deponive në Prishtinë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan dhe Podujevë deri në fundin e vitit 2011. Punimet për pastrimin dhe mbulimin e lokacionit filluan në vitin 2010. Është instaluar sistemi i ri i drenazhes, i sistemit të monitorimit të ujit nëntokësor, dhe i puseve të biogazit, si dhe janë përgatitur hapësirat për mbjellje të pemëve dhe të përmirësimit të peizazhit në përgjithësi.

### Një kryeqytet më i pastër

Hapësira tejet e madhe e deponisë së pakontrolluara në Prishtinë ka bërë që projekti ta përqendrojë më shumë se 40 për qind të punimeve dhe të financimit për këtë lokacion. Ndotja e ajrit, dheut, dhe e ujit përreth ka arritur në shkallën alarmuese sa që qindra banorë nuk mund t'i hapnin dritaret e shtëpive të tyre. Disa prej tyre madje edhe janë zhvendosur që të jetojnë diku tjetër.

Tani banorët lokalë janë kthyer në këtë zonë. “Para se të mbyllej deponia e vjetër ne rrezikoheshim për çdo ditë të ngulfateshim nga tymi që vinte nga bërlloku. Tani na është kthyer jeta!”, shprehet një banor i cili jeton afër deponisë. Menaxhimi i deponisë së re do të bartet te komuna e Prishtinës. “Komuna planifikon të mbjellë në këtë hapësirë dhe ta gjelbërojë këtë pjesë për aktivitete rekreative”, thotë z. Agim Gashi, drejtor i Shërbimeve Publike.

### Trajtimi i kanalizimeve dhe cilësia e ujit

Mbledhja dhe trajtimi efektiv dhe i qëndrueshëm i ujërave të kanalizimeve është një ndër objektivat kryesore të politikave mjedisore të BE-së. Sistemi ekzistues i kanalizimit në Kosovë nuk është efikas dhe është i papërshtatshëm kur kihet parasysh shfrytëzimi aktual dhe i ardhshëm. BE-ja e ka identifikuar përmirësimin e këtij sektori si diçka urgjente, dhe po hulumton iniciativën të ndryshme anë e mbanë vendit.

Cilësia e ujit në lumin Klina, i cili e përshkon pjesën qendrore të Kosovës, është përmirësuar dukshëm që prej dhjetorit të vitit 2011. Falë investimit të BE-së, komuna e Skenderajt tani e ka një impiant të ri të trajtimit të kanalizimit, i cili u shërben rreth 8,000 banorëve. Sistemi i ri siguron që vetëm uji i trajtuar dhe i sigurt në aspektin mjedisor të shkarkohet në lumin e afërt të Klinës dhe në përrenjtë e vegjël.

Edhe katër rrjete më të vogla të kanalizimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave janë duke u ndërtuar në Kuk (Dragash), Skivjan (Gjakovë), Junik, dhe Medvec (Lipjan). Impiantet e reja do t'ju shërbejnë popullatave që variojnë prej 1,100 deri në 3,400 banorë. Në ndërkohë, është duke u realizuar një anketë sa i përket sistemeve të kanalizimit në shtatë qytezat dhe qytetet më të mëdha të vendit, duke përfshirë Prishtinën, ku nevojiten investime të mëdha për t'i përmbushur nevojat e një popullsie gjithnjë në rritje.

### Pyjet

Rreth 41 për qind të territorit të Kosovës është e mbuluar me pyje. Është me rëndësi që të mbrohen këto pyje, dhe në të njëjtën kohë të sigurohet që sektori i pyjeve ta luajë rolin e vet në forcimin e ekonomisë.

Kosova është e përkushtuar që t'i ruaj pyjet e veta dhe t'i promovojë ato nga aspekti turistik. Projektet mbështetëse të BE-s ofrojnë udhëzime për autoritetet lokale se si të menaxhohen pyjet publike dhe private, dhe si të stimulohet zhvillimi rural sipas praktikave më të mira evropiane.





MBJELLJA E FARËS PËR ZHVILLIM RURAL





Industria bujqësore është duke e rimarrë pozitën e vet si punëdhënësi kryesor në Kosovë. Bashkimi Evropian deri më sot ka investuar rreth 70 milion euro për ta mbështetur zhvillimin bujqësor dhe rural në Kosovë. Pjesë e financimit të BE-së ka qenë edhe themelimi i agjencive rajonale për zhvillim, skemave të granteve, dhe trajnimi i bujqve sa i përket metodave moderne në bujqësi.

Më shumë se 30 bujq dhe shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme në Kosovë janë njoftuar me standardet bujqësore të Evropës përmes projekteve të financuara nga BE-ja dhe këshillave të marra nga ekspertët, që kanë çuar në rritjen e mundësive për punësim dhe prosperitetin në tërë Kosovën. Ndihamë e bujqve në rritjen efikase të prodhimit të tyre do të luaj rol thelbësor në zëvendësimin e mallrave të importuara ushqimore me produkte vendore të bujqësisë.

### Fermtat model

Shumica e projekteve sponsoruese të granteve rurale menaxhohen nga OJQ-të. Njëri prej projekteve të financuara nga BE-ja iu besua Iniciativës për Zhvillim e Bujqësisë në Kosovë (IADK), një OJQ me më shumë se 10 vjet përvojë në përkrahjen e sektorit bujqësor në Kosovën veriore. Katër ferma model, për përpunimin e frutave, gjedhëve, rritjes së mollëve, dhe kultivimit të serrave, u zhvilluan nën mbikëqyrjen e IADK-së. Fermtat model përdoren për të demonstruar metoda dhe teknologji moderne të bujqësisë. “Shumë bujq kanë përfituar nga këto demonstrime, pasi disa teknika të caktuara nuk njiheshin nga ta më përpara”, shprehet drejtori i IADK-së Zenel Bunjaku.

Bujqve u ofrohet më pastaj trajnim përmes asociacioneve të fermerëve, në bashkëpunim me IADK-në. Njëri prej kurseve të trajnimit është krijuar pikërisht për t’ua mësuar grave shkathtësitë për përpunimin e frutave dhe të perimeve. Në të ardhmen e afërt do të botohet një doracak trajnimi për bujq.

### Të mbjellat në serrë!

Në rajonin e Mitrovicës, skema e granteve dhe trajnimi profesional kanë treguar rezultate mbresëlënëse. Në fshatin Çabër, në veri të Mitrovicës, mund të shihet që nga largësia një serrë 500 metrash katror. Përkundër kushteve klimatike nën zero që mbretërojnë jashtë, temperatura brenda serrës mbetet konstante në 25°C që bima e spinaqit të rritet pa problem.

Ahmet Uka, 42 vjeçar, përdor tani metoda të reja të rritjes së fidanëve. “Një grant më ka ndihmuar që ta rris prodhimin dhe biznesin tim. Tani mund t’i korrë frytet e prodhimit të tri herë në vit në vend të një here si më parë”, u shpreh ai.

Uka është kthyer në Kosovë në vitin 2000 pas më shumë se 20 vjetëve përvojë në bujqësi në Gjermani. Pak vite më parë ai filloi t’u shes fidane bujqve të tjerë. Shitjet fillestare i kishte në 500 fidane në vit. Këtë vit ai planifikon të shes 20,000 fidane, me një parashikim për shitje prej 30,000 sosh për çdo vit në të ardhmen. Uka gjithashtu ka prodhuar mbi 10 tonelata domate në vjeshtën e vitit 2011.

### Një qasje e re për shpërndarje

Në rajonet e pleshme bujqësore të Kosovës jugore është krijuar një impiant për mbledhjen dhe përpunimin e frutave dhe perimeve në fshatin Xërxe.

U rinovua një objekt ekzistues dhe u pajis me makina për matje, frigoriferë, dhe vinç ngarkues. Tani prodhimet nga fermtat lokale mbledhen në pikën grumbulluese që të klasifikohen, paketohen dhe t’u vendoset etiketa para se t’u shpërndahen shitësve me shumicë apo të eksportohen.

Impianti shërben si pikë grumbulluese për bujqit e rajonit të Rahovecit, Mamushës, Prizrenit dhe Suharekës, të cilët kultivojnë specin, domaten, kastravecin, rrushin dhe lakrat. Bujqit tani e dijnë destinacionin përfundimtar të prodhimeve të tyre madje edhe para se t’i mbjellin farën e tyre. Mundësia për të planifikuar që përpara u ndihmon bujqve t’i pakësojnë humbjet, ta përdorin me efikasitet fuqinë punëtore, dhe si rrjedhojë t’i përmirësojnë të ardhurat e tyre. “I humbim frutat dhe perimet që na mbetnin kur nuk kishte më blerës. Kjo pikë grumbulluese na jep mirëbesim se të gjitha prodhimet tona do të shiten”, thotë bujku lokal Nebih Morina. Përveç njoftimit të bujqve me konceptin e ri të pikës grumbulluese, edhe trajnimet e veçanta në metodat e kultivimit modern u ndihmojnë atyre që të kenë prodhime të cilësisë së lartë. Rreth 200 bujq e kanë kryer trajnimin, dhe të cilët në mënyrë të rregullt i dërgojnë prodhimet e tyre në këtë pikë grumbulluese.

Projekti u mundësua përmes një investimi të BE-së së bashku me një kontribut të vogël nga autoritetet lokale të Rahovecit. Pika grumbulluese pritet që t’i përpunojë afër 2,000 tonë të frutave dhe perimeve në çdo sezon. Janë hapur mundësitë e tregjeve, dhe se janë nënshkruar kontrata të reja me blerësit me shumicë rajonal dhe evropian.

### Grantet e vogla – ndikimi i madh

Grantet e vogla kanë qenë instrumentale në rigjallërimin e ekonomisë rurale në rajonin e Prizrenit. Këto investime monetare kanë provuar të jenë tejet të çmueshme për bizneset e vogla dhe për bujqit me prodhimtari të vogël, duke u ndihmuar që ta rrisin produktivitetin dhe konkurrancën e tyre në treg.

### Nga prodhimi manual në atë automatik

Prodhuesi i verës, Florim Shulina, është një person shumë i lumtur. Tanimë ai nuk ia vendos secilës shishe etiketën me dorë! Me lokacion në rajonin e Rahovecit, i famshëm për verën e cilësisë së lartë, biznesi i Shulinës filloi të zhvillohej më tej kur iu dha një grant i BE-së që i mundësoi blerjen e një makine për vendosjen e etiketave në mënyrë automatike.

“Na shkonte e gjithë dita vetëm t’i vendosnim etiketat disa arkave të verës. Tani kjo bëhet brenda disa sekondave”, shprehet ai. Vera e tij “Shulina” mund t’i përmblush nevojat e tregut me sasi të mjaftueshme, dhe se ai nuk ka nevojë të shqetësohet nëse etiketat janë vendosur gabimisht!

### Bletët: kthimi i pasionit në biznes

Është mars, dhe në fshatin Mirditë, pak përtej Prizrenit, bletari Ndue Nokaj po e hap kosheren e tij për herë të parë në vitin 2012. Ai ka nevojë t’i kontrollojë bletët e tij nëse janë të shëndetshme pas një dimri të gjatë dhe të ftohtë.

Në këtë vit, ai do të nxjerrë më shumë mjaltë se zakonisht. “Granti më ka ndihmuar që ta rris numrin e koshereve në kohën e duhur”, thotë z. Nokaj, i cili e mban familjen e tij përmes pasionit për bletët. Skema e grantit i ka ofruar z. Nokaj, dhe shumë bletarëve të tjerë, edhe trajnime për mirëmbajtjen e bletëve.





## PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NË KOSOVË



Që prej vitit 1999 investimet kapitale në infrastrukturë kanë qenë të prioritetit të lartë në Kosovë për shkak të nevojës urgjente për përmirësimin e rrugëve, aeroporteve, rrjetit të hekurudhave, objekteve spitalore, rrjetit të furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimit.

Krijimi i një infrastrukture moderne është thelbësore për rritjen ekonomike të Kosovës. Bashkimi Evropian është duke i përkrahur projektet që e ndihmojnë Kosovën ta përmirësojë infrastrukturën e saj për t'i përmbushur standardet evropiane.

### Përmirësimi i transportit rrugor

BE-ja ka ndarë 50 milionë euro për përmirësimin e rrjetit të rrugëve. Deri më sot janë riparuar ose ndërtuar 300 kilometra të rrugëve magjistrale dhe 30 rrugëve lokale në mbarë Kosovën.

Një projekt madhor ishte rindërtimi i 17 urave në M2 – një arterie kryesore e cila e lidh Kosovën me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Urat u përforcuan dhe u riparuan në pajtim me standardet Eurocode që janë të obligueshme për trafikun e rëndë dhe të automjeteve ushtarake.

Përmirësimet e kohëve të fundit sa i përket cilësisë së rrugëve e ka rritur mundësinë për zhvillim ekonomik dhe ka krijuar kushte më të mira për bashkëpunim përtej kufijve. Përveç kësaj, qasja më e lehtë në qyteza dhe qytete e ka rritur cilësinë e jetës për popullsinë në zonat rurale. Si një zhvillim tjetër pozitiv, punimet nëpër rrugë kanë ofruar punësim për një numër të madh të njerëzve, si dhe u ka dhënë mundësinë që t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre në harmoni me standardet evropiane për ndërtim dhe siguri.

### Një qendër e re e kujdesit shëndetësor

Në nëntor të vitit 2011 u hap një qendër e re e kujdesit shëndetësor në Vushtri. Objekti u shërben më shumë se 100,000 banorëve lokalë, dhe u financua nga BE-ja me një kosto prej afro 800,000 eurove.

Qendra e re ofron shërbime gjithëpërfshirëse të kujdesit shëndetësor; për shembull, ka një departament për aksidente dhe emergjencë, pajisje për rëntgen, laboratorë mikrobiologjikë, si dhe klinika për pediatri,

obstetri dhe gjinekologji, mjekësi të përgjithshme, dhe stomatologji. Po ashtu ka edhe salla për praktikantë, salla të infermierisë, si dhe hapësirë të mjaftueshëm për administratë.

Ndërtimi i qendrës u bë në harmoni të plotë me standardet e ndërtesave evropiane, të cilat ofrojnë qasje të përshtatshme si dhe pajisje të duhura të brendshme për personat me aftësi të kufizuara. Objekti është pajisur edhe me panele solare për ta bërë atë efikase sa i përket shfrytëzimit të energjisë.

Banorët lokalë janë të kënaqur me këtë qendër të re të kujdesit shëndetësor. Pacientëve u pëlqejnë dhomat e përshtatshme të pritjes, si dhe shenjat e qarta të cilat i orientojnë tek departamentet e ndryshme. Asllani pesëdhjetë e gjashtë vjeçar ka nevojë për kontrolle të rregullta mjekësore për shkak të sëmundjes kronike të tij në organet e frymëmarrjes. Ai është i lehtësuar pasi qendra është afër shtëpisë së tij dhe i gëzohet mikpritjes së ngrohtë që merr gjatë vizitave që i bën.

### Rrjeti i ujësjellësit

Projektet e tjera infrastrukturore janë përqendruar në përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit dhe sistemit të kanalizimit. BE-ja ka investuar gjithsej 60 milionë euro për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në tërë Kosovën.

Dy milionë euro të këtyre fondeve janë shpenzuar në zëvendësimin e dy kilometrave të gypave të vjetruar të ujit në Prishtinë. Rezultatet e kanë përmirësuar cilësinë e ujit, i kanë zvogëluar humbjet e ujit, si dhe e kanë rritur kapacitetin e ujit për afro 70 për qind të banorëve të qytetit. Një projekt tjetër 13 milionësh është realizuar në rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe përmirësimin e impiantit për trajtimin e ujit në Mitrovicë. Ky impiant i shërben katër komunave me gjithsej 250,000 banorë, dhe i ka dyfishuar kapacitetet përpunuese që në përfundimin e tij në vitin 2012.

### Përmirësimi i cilësisë së ujit

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike është pajisur me pajisje të reja laboratorike për testimin e cilësisë së ujit. Donacioni ka ardhur nga BE-ja pas rekomandimeve të dala nga studimi i fizibilitetit në lidhje me shëndetin publik në Kosovë. (Rekomandimet e tjera përfshijnë investimet për rehabilitimin e impianteve për trajtimin e ujit dhe të pompave, dhe të instalimit të njehsorëve të ujit).


“Njerëzit kanë qenë gjithnjë të vetëdijshëm për çështjet e shëndetit publik, por projektet e BE-së janë duke ndihmuar në përvetësimin e standardeve evropiane për shëndetin publik”, thotë Burbuqe Nushi-Latifi, shefe e Departamentit për ujë dhe sanitari në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike.





## SHFRYTËZIMI I NDËRGJEGJSHËM I ENERGJISË





Sektori i energjisë në Kosovë vazhdon të ballafaqohet me sfida. Me një prodhim të ulët të energjisë dhe me një konsum të lartë të saj, ndërprerjet e rrymës elektrike në Kosovë mbesin një rutinë. Historikisht, burimi kryesor i energjisë në vend kanë qenë minierat e qymyrit. Megjithatë, këto miniera pothuajse janë shfrytëzuar në tërësi gjatë vjetëve të fundit.

Njëra prej objektivave kryesore të Kosovës është zvogëlimi i konsumimit të energjisë deri në nëntë për qind në vitin 2018. Rritja e efikasitetit të energjisë është pjesë thelbësore e planit gjithëpërfshirës. Një projekt prej 2 milionë eurosh po e mbështet trajnimin dhe certifikimin e 55 auditorëve të energjisë të cilët do t'i identifikojnë potencialet për masat e efikasitetit të energjisë. Projekti ka përfshirë një fushatë publike për inkurajimin e kursimit të energjisë, dhe shfrytëzimit të burimeve të përsëritshme të energjisë.

### Traktati i Komunitetit të Energjisë

Kosova është pjesë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë i cili synon përfshirjen e vendeve të Evropës juglindore në tregun e gjerë evropian të energjisë. Synimi i traktatit është rritja e investimeve në këtë sektor, dhe si rrjedhojë përmirësimi i aftësive planifikuese dhe përmirësimi të besueshmërisë në furnizimin me energji në rajon. Në harmoni me legjislacionin e BE-së për energji dhe mjedis është nënshkruar në nëntor të vitit 2011 një marrëveshje për zvogëlimin e konsumimit të energjisë dhe përmirësimin të efikasitetit të saj në Kosovë.

Në harmoni me këtë marrëveshje, BE-ja po ofron mbështetje teknike për sistemin e prodhimit të ngrohjes në Prishtinë. Ky sistem inovativ e shfrytëzon nxehtësinë që prodhohet nga gjeneratorët që furnizohen nga qymyri, nxehtësi që përndryshe do të lirohej në ajër. Ngrohtorja publike rajonale e Prishtinës do të mund të ofrojë ngrohje të qëndrueshme për popullsinë e Prishtinës përmes një teknologjie të integruar dhe efikase të karburantit.

### Rehatia në klasa

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në objektet publike është një sfidë tjetër e madhe për Kosovën. Me rreth 2,500 nxënës, shkolla Ismail Qemajli është njëra prej shkollave më të mëdha fillore në Prishtinë. Deri vonë fatura për karburant e shkollës në sezonin e dimrit përbënte një pjesë të madhe të shpenzimeve vjetore të saj. Megjithatë, përkundër shpenzimeve të mëdha financiare, nxënësit dhe mësimmidhësit duhej të mbanin palltot e tyre në klasë me qëllim që të ngroheshin.

Falë investimeve të BE-së shkolla Ismail Qemajli jo vetëm që është më e ngrohtë, por edhe me efikase në shfrytëzimin e energjisë. Objekti i shkollës është pajisur me dyer e dritare të reja si dhe me izolim të mirë të mureve dhe të kulmit. Panelet solare kontribuojnë në një kosto më të ulët të energjisë. Temperatura brenda në shkollë është konstante, dhe se nxënësit dhe mësimmidhësit tanimë mund të përqendrohen në mësim sesa në të ftohtin që mbretëronte më parë!

Që prej renovimit shkolla e ka zvogëluar konsumimin e energjisë deri në 50 për qind, si dhe emetimin e CO<sub>2</sub> deri në 260 tonë. "Shpenzimet për energji kanë rënë pothuaj përgjysmë", shprehet zëvendës drejtori i shkollës, Bajram Vrapçani, duke shtuar se shkolla ngrohet për një periudhë shumë më të shkurtër falë izolimit të përmirësuar.

Edhe masa të ngjashme të kursimit të energjisë janë bërë në një shkollë tjetër të Prishtinës, si dhe në dy shkolla të tjera në Gjakovë, dhe në qendrën e maternitetit të spitalit rajonal në Gjilan. Jo vetëm që renovimi ka përmirësuar nivelin e rehatisë së personave që veprojnë në këto objekte, porse edhe konsumimi i energjisë pritet të bie së paku për 40 për qind, me një zvogëlim të dukshëm të emetimit të CO<sub>2</sub>.

### Miniera e re në Sibovc

BE-ja iu ka përgjigjur aplikacionit të autoriteteve kosovare për ta hapur një minierë të re të qymyrit në fshatin Sibovc. Miniera e re e ka potencialin që të ofrojë qymyr të bollshëm për funksionimin e termocentraleve ekzistuese kur të kenë mbaruar furnizimet ekzistuese. Iniciativa përfshinë përmirësimin e makinerisë ekzistuese të minierave, një masë e cila do ta përmirësojë sigurinë dhe do ta rrisë kapacitetin gërmues që vlerësohet për 50 për qind.

"Miniera e Sibovcit është projekti më i madh i energjisë në Kosovë gjatë dy dekadave të fundit. Miniera ka një kapacitet eksploatues prej 124 milionë tonë qymyr", thotë Arben Gjokaj, drejtorë Menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Projekti është vlerësuar të jetë 17 milion euro dhe është bashkë-financuar nga buxheti i Kosovës. Pritet që miniera e re do ta stabilizojë furnizimin me rrymë elektrike dhe do t'i përmirësojë kushtet e jetës për popullin e Kosovës. Do të ofrojë edhe një mundësi tërheqëse për investuesit si në rajon ashtu edhe jashtë tij.

Me shfrytëzim e makinerisë të posa rinovuar, faza e parë e largimit të dheut nga sipërfaqja e lokacionit të minierës ka filluar në vitin 2011.



A woman in a grey blazer is walking on a staircase. She is holding a smartphone in her right hand, a red 2012 calendar in her left hand, and a red quilted bag. The background shows the metal railings of the staircase.

# KRIJIMI I MIRËBESIMIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE





Reforma administrative është një proces i vazhdueshëm, dhe zakonisht i ngarkuar me vështirësi. Kosova aktualisht e ka rritur më të madh të organeve administrative, kostoja e të cilave e tejkalon tej mase buxhetin e alokuar për to. Si hap i parë për stimulimin e prosperitetit socio-ekonomik, administrata publike në Kosovë ka nevojë për përmirësim të efikasitetit dhe llogaridhënies së saj, t'i zvogëlojë kostot e brendshme, dhe të ofrojë shërbime më efikase publike.

### Prokurimi publik

Bashkimi Evropian është duke e ndihmuar administratën e Kosovës që të njihet më për së afërmi me proceset legjislative evropiane, si dhe të zbatimit të kësaj njohurie dhe ekspertize në politik-bërjen e vet.

Në tetor të vitit 2011, Kuvendi i Kosovës e miratoi ligjin e ri të prokurimit publik, duke shënuar fundin e 10 viteve fushate të BE-së për inkurajimin e reformave në këtë sektor. Legjislacioni i ri është hartuar që të sigurojë efikasitet dhe shfrytëzim transparent të fondeve publike, si dhe shfrytëzim të përpjesëtueshëm të burimeve. Shtrëngimi i proceseve publike të prokurimit do të ndihmojë në luftimin kundër korrupsionit, si dhe do ta shtrojë rrugën drejt një qëndrueshmërie ekonomike dhe politike në Kosovë. BE-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë pushtetit lokal, i cili është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve parësore për publikun. Bashkëpunimi evropian për komuna më të fuqishme është titulli i një projekti të BE-së që synon përforcimin dhe efikasitetin e administratës së pushtetit lokal në Kosovë. Shumica e komunave tani kanë krijuar zyra për koordinim me BE-në. Megjithatë, duhet të bëhet edhe më shumë për përmirësimin e shërbimeve për qytetarët lokalë.

### Mbështetja e auditorit

Një prioritet tjetër i BE-së është edhe mbështetja e vazhdueshme e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të fondeve publike në Kosovë.

Me ndihmën dhe udhëzimin e ekspertëve nga shtetet anëtare të BE-së, është reformuar korniza ligjore e ZAP. Më parë nën përgjegjësinë e vetme të UNMIK-ut, ajo tani është bërë një institucion shtetëror. Për më shumë, janë bërë përmirësime të dukshme në menaxhimin, administrimin dhe shkathtësitë audituese të zyrtarëve të ZAP. ZAP tani është në gjendje të ofroj raporte të cilësisë së lartë dhe me kohë. Publiku tani e kupton më mirë funksionimin e ZAP, dhe është shndërruar në një organizatë të respektuar.

### Regjistrimi i ri i popullsisë

Regjistrimi i parë i popullsisë dhe ekonomive familjare pas tri dekadash u bë gjatë muajit prill të vitit 2011 në Kosovë. Të dhënat e regjistrimit janë të rëndësishme për shumë sektorë të shoqërisë, duke përfshirë bizneset, organizatat ndërkombëtare, institucionet hulumtuese dhe akademike, dhe veçanërisht politik-bërësit në nivelin komunal dhe qeveritar. Regjistrimi i vitit 2011 do të ofrojë një pasqyrë të Kosovës moderne dhe të profilit të saj socio-ekonomik dhe të kushteve të strehimit të banorëve të saj.

Një ekip prej 27 ekspertëve për regjistrim nga Trupi Monitorues Ndërkombëtar e monitoroi procesin e regjistrimit për të siguruar se do t'i përmbushte standardet profesionale të cilësisë, transparencës dhe paanshmërisë. BE-ja ofroi 3.8 milionë fonde për këtë proces. "Ekspertiza e ofruar nga BE-ja gjatë këtyre vjetëve ka qenë thelbësore për mbledhjen e statistikave sipas standardeve ndërkombëtare", shprehet Isa Krasniqi, shef ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës. "Agjencia ka mbledhur të dhëna të besueshme të cilat mund të përdoren si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës."

Të dhënat e sakta demografike për popullsinë e Kosovës do të ndikojnë në planifikimin e qeverisë dhe të zhvillimit të politikave gjatë dekadës së ardhshme. Po ashtu do të përditësohen të dhënat statistikore të Kosovës në EUS-TAT dhe në agjencitë e tjera në mbarë botën.

Një zhvillim pozitiv prej regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare ka qenë të kuptuarit më të mirë të nevojës së personave me aftësi fizike në Kosovë.

Mbështetja për personat me aftësi të kufizuar administrohet prej Zyrës së Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, e cila ka qenë përgjegjëse për zbatimin e planit shtetëror të veprimit për personat me aftësi të kufizuar që prej vitit 2009.

Pyetësori i regjistrimit të popullsisë përfshinte një listë të vështirësive kronike që mund të përjetoheshin nga personat me aftësi të kufizuar. Pjesëmarrësve iu kërkua që ta shënonin rubrikën që perkonte me ta si individ. Rezultatet e vunë në pah rëndësinë thelbësore të ndarjes së burimeve aty ku ka nevojë më së shumti, dhe bëri që të rishikohet tërësisht plani ekzistues i politikave.

Qeveria italiane është duke e mbështetur zbatimin e Planit të veprimit për persona me aftësi të kufizuara. "Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë do të jetë me rëndësi të madhe për ridefinimin e politikave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara", shprehet Dolares Mattosovich, menaxhere e projektit për mbështetje të Planit Kombëtarë të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuar të Kosovës.





RIKTHIMI I BESIMIT NË SUNDIMIN E LIGJIT





Sundimi i ligjit në Kosovë është duke luftuar për ta kthyer besimin në gjyqësor. Reformat e gjera janë thelbësore që ta ofrojnë sistemin e drejtësisë së vendit në harmoni me standardet evropiane. Bashkimi Evropian është duke ndihmuar të arrihet kjo përmes mbështetjes në hartimin e ligjeve të reja, kontributit përmes investimeve kapitale në infrastrukturën ligjore, si dhe duke e përkrahur një qasje të re për përzgjedhjen dhe verifikimit të gjykatësve dhe prokurorëve publik.

### Verifikimi i kandidatëve ligjor

Hartimi i procedurave të reja për analizimin e standardeve profesionale dhe etike të pjesëtarëve të gjyqësorit ka qenë njëra prej arritjeve më kryesore në përpjekjet e përbashkëta mes BE-së, qeverisë së Shteteve të Bashkuara, dhe institucioneve ligjore në Kosovë. Më shumë se 300 kandidatë për emërim në gjyqësor kaluan nëpër një sistem të ri të verifikimit. Aty u përfshinë gjykatësit ekzistues dhe prokurorët publik si dhe aplikuesit të cilët konkurronin për herë të parë.

Kandidatët iu nënshtruan një provimi lidhur me kodet ligjore të etikës. Vetëm ata që e kaluan provimin u kualifikuan që të aplikojnë për punë. U bënë hetime për ta parë historikun e secilit kandidat. Kjo u pasua me intervista të hollësishme, si dhe prej një analize të performancës së secilit individ.

Në fund të procesit përzgjedhës, afro 60 për qind e kandidatëve të suksesshëm ishin të rinj në punë, duke futur kështu një gjak të ri vital në sistemin gjyqësor të Kosovës. E tërë procedura ishte bashkë-financuar nga BE-ja dhe qeveria e SHBA-ve me një kosto prej afro 5.9 milion eurove.

### Ngritja e standardeve

Standardet evropiane me objektivitet ligjor ishin zbatuar si pjesë e procedurës së verifikimit. “Mbi të gjitha, dëshmitë e qarta të standardeve dhe procedurave transparente dhe objektive janë me rëndësi të veçantë për rikthimin e besueshmërisë në sistemin gjyqësor”, shprehet Musa Dragusha, kryetar i Odës së Avokatëve. Ai është op-

timist që ky sistem i rreptë i verifikimit të gjyqësorit do t’u jap qytetarëve të Kosovës më shumë besim që t’i dërgojnë rastet e tyre në gjykata.

Nënshtrimi i gjykatësve dhe prokurorëve publik ndaj një verifikimi më të hollësishëm profesional ka qenë i mirëseardhur prej Agjencisë Kundër Korrupsionit. “Gjyqësori është një ndër degët më të kritikuara të pushtetit administrativ, dhe është me rëndësi që të rikthehet besueshmëria e tij”, shprehet Mentor Borovci, zëvendës shef i kësaj agjencie. Agjencia Kundër Korrupsionit i ka dërguar disa raste në zyrën e prokurorisë në të kaluarën. Megjithatë, vetëm disa prej tyre u hetuan.

### Trajnimi i vazhdueshëm

Përforsimi i gjyqësorit është një proces i vazhdueshëm. Gjykatësit dhe prokurorët publik (si ata aktual edhe ata që aspirojnë) pritet të marrin pjesë në praktikë profesionale dhe në kurse të ndryshme trajnimi për ta përmirësuar ekspertizën e tyre. Një theks i veçantë i kushtohet çështjeve që kanë të bëjnë me të ardhmen e integritimit në BE dhe ligjeve evropiane sa i përket të drejtave të njeriut lidhur me gratë dhe grupet e pakicave.

Në ndërkohë që publikimet ligjore janë duke u hartuar përmes Qendrës Juridike të Kosovës për ta plotësuar zbrazëtirën e burimeve ekzistuese në këtë fushë. Ligjet do të publikohen krahas buletineve të gjykimeve në gjykata.

Reforma që po ndodhin në sektorin e sundimit të ligjit pa dyshim se janë duke e quar gjyqësorin në drejtimin e duhur.

### Reformimi i sistemit të drejtësisë për të mitur

Projekti për reformimin e sistemit të drejtësisë për të mitur është një iniciativë e përbashkët e BE-së dhe UNICEF-it, i cili ka të bëjë me reformimin e kodit për drejtësi për të mitur. Ai synon që ta përmirësojë trajtimin e fëmijëve që bien ndesh me ligjin, dhe ngritjen e procedurave aktuale në harmoni me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të drejtësisë për të mitur.

Projekti i kushton theks të veçantë trajnimit të atyre që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët e rrezikuar; për shembull, me mësimmëdhënësit, punonjësit social, dhe zyrtarët e policisë. Po ashtu i shtyn autoritetet juridike që të hartojnë protokolle specifike referuese për përfaqësimin ligjor dhe trajtimin e fëmijëve gjatë arrestimit dhe masave hetuese.

Masat reformuese do ta përmbushin zbrazëtirën institucionale në direktivat ligjore për trajtimin e shkelësve të mitur, viktimave, ose dëshmitarëve të krimit. Janë krijuar dhomat miqësore për fëmijë për qëllim të marrjes së tyre në pyetje në stacionet policore në Prishtinë, Prizren, Pejë, Vushtrri, Gjiçan, Ferizaj dhe Graçanicë.

### Një vend i ri për drejtësinë

Përmirësimi i infrastrukturës ligjore është një ndër sfidat më të mëdha të këtij sektori. Punimet janë duke u bërë për një pallat të ri të drejtësisë në Prishtinë me qëllim të ofrimit të objekteve të përshtatshme për autoritetet ligjore dhe për përmirësimin e statusit të tyre të pavarur. Përmirësimi i shërbimeve dhe pakësimi i rasteve të grumbulluara tashmë do të ndihmojë në përmirësimin e besimit në gjyqësor. BE-ja gjithashtu po e financon ndërtimin e një burgu të sigurisë së lartë.



Dhjetë shanset më të mira evropiane të Kosovës  
ISBN 978-92-9238-101-1  
DOI 10.2871/45419

Tekst-shkrues:  
Veton Kasapolli

Redaktore:  
Harriet Milles

Dizajni dhe faqosja:  
Florim Mehmeti

Fotografitë:  
Astrit Ibrahim

E drejta e autorit: Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Lejohet kopjimi në rast se jepen informacionet rreth burimit.

Përkthimi dhe printimi: Zyra e BE-së në Kosovë, 2013.



